



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale Ndërtimi për Sektorin Funeral”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 14211000-3, 14212430-3, 14711000-8, 44111200-3.

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 97126-08-24-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,897,668 (kater milion e tetëqind e nentëdhjetë e shtate mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa Tvsh.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: *"...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*, Neni 82, i LPP *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në SPE, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kerkesat per kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi,

me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet për transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi, me qira ose në huapërdorje.

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi ose qira ose huapërdorim

Shenim 3.1: Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit, huadhenesit dhe huapërdoresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

OE duhet të disponojë të paktën një mjet pesha totale e të cilit (pesha e mjetit + pesha e ngarkuar) të jete jo më shumë se 40 Ton me qëllim transportin e mallit objekt prokurimi. Mjeti duhet të jete i pajisur me vinc shkarkues, për shkarkimin e Cimentos dhe të Hekurit.

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesipër pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Ky kriter quhet i përmbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe në bazë të nenit 26, pika

6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: *“6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”*

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit përfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve

provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

Gjithashtu, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën një mjet me peshë totale (pesha e mjetit së bashku me ngarkesën) jo më shumë se 40 ton është vendosur për të garantuar aksesin dhe lëvizjen e sigurt të mjetit në rrugët urbane dhe në ambientet e varrezave, duke shmangur dëmtimin e infrastrukturës rrugore dhe duke respektuar kufizimet ligjore të qarkullimit. Po kështu, kërkesa që mjeti të jetë i pajisur me vinç shkarkues është e domosdoshme për realizimin e shkarkimit të çimentos dhe hekurit në vendet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi natyra, pesha dhe përmasat e këtyre materialeve nuk mundësojnë shkarkimin manual në kushte sigurie dhe efikasiteti. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, garanton realizimin e furnizimit në kohë dhe në mënyrë të sigurt, si dhe është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

4. Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne Çertifikate ISO 9001:2015 duhet të jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Çertifikate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise. Ky standart aplikohet per cdo shoqeri pavaresisht madhesise ose fushes se aktivitetit.

5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese ne SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhuesi per artikujt: “**Çimento**“, dhe “**Hekurit**”. Ne rastet e autorizimit nga distributori, duhet te vertetohet lidhja qe distributori ka me prodhuesin. Ne autorizim duhet te jete i paraqitur Nr i references se procedures se prokurimit si dhe te dhena te sakta te Prodhuesit/Distributorit ne menyre qe AK te kete mundesi te kryej verifikimet e nevojshme.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kërkesa që në autorizim të pasqyrohet numri i referencës së procedurës së prokurimit është e nevojshme dhe proporcionale, pasi garanton që autorizimi është lëshuar specifikisht për këtë procedurë prokurimi dhe jo një autorizim i përgjithshëm, i papërcaktuar apo i përdorur njëkohësisht në procedura të ndryshme.

Ky element i shërben autoritetit kontraktor që të verifikojë autenticitetin dhe vlefshmërinë e autorizimit; të sigurojë lidhjen direkte të prodhuesit/distributorit me procedurën konkrete të prokurimit; të shmangë paraqitjen e autorizimeve të përgjithshme, të pavlefshme ose të ripërdorura; të garantojë gjurmueshmërinë dhe transparencën e dokumentacionit të paraqitur; të krijojë mundësinë për kryerjen e verifikimeve administrative pranë prodhuesit/distributorit; garantimin e seriozitetit të ofertës dhe sigurimin e furnizimit me mallrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE certifikatën për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, të lëshuar nga organet kompetente, në rast se transporti i mallrave do të kryhet me mjetet në pronësi të tij. Në rast se mjeti i transportit është marrë me qira, operatori ekonomik certifikatën për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit, të lëshuar nga organet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës për transport mallrash brenda vendit, të lëshuar nga organet kompetente, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e mallrave objekt prokurimi, të

cilat përbëhen nga materiale ndërtimi me peshë dhe volum të konsiderueshëm, si çimento, hekur, rërë dhe materiale të tjera ndërtimore, të cilat kërkojnë transport të përshtatshëm dhe të realizuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet dhe autorizimet e nevojshme ligjore për realizimin e transportit të mallrave deri në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, duke siguruar furnizimin në kohë, në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa administrative gjatë zbatimit të kontratës.

Paraqitja e këtij dokumentacioni nuk synon kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, por garantimin që transporti i materialeve të ndërtimit të kryhet nga subjekte që plotësojnë kërkesat ligjore për ushtrimin e këtij aktiviteti. Në rastet kur operatori ekonomik nuk disponon mjete transporti në pronësi, lejohet përdorimi i mjeteve të marra me qira, duke paraqitur dokumentacionin përkatës që provon të drejtën e përdorimit dhe autorizimin përkatës për transportin e mallrave.

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Shenim: Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jenë paraqitur si markë/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Shenim: Mos dorezimi i informacionit të saktë apo dorezimi i rreme do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për perjashtim të O.E. nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Materiale Ndertimi per Sektorin Funeral

1. Cimento marka 400.

Parametrat teknike :

MARKA 400

Specifikimi i Materialeve :

Cimento do te jete e markes 400,e paketuar ne thase 25 kg

2. RERE E LARE LUMI

Specifikimi i Materialit

Rera te jete e lare e paster pa perzierje te tjera

3. GRANIL 1mm

Specifikimi i Materialit

Granili te jete gure lumi i coptuar ne kokrra te me diameter Ø=1

4. ZGARE HEKURI Parametri teknik :Hekur Ø=4.2 mm i viaskuar

Permasat e zgares 500 cm*250 cm
Hapsira e kuadratit te zgares 15 cm*15 cm
Sigma = 2400 Kg/ cm2

5. PROFILE HEKURI

Permasat e profilin 40cm x 20cm, spesor δ 2 mm

6. LLAMARINE

Permasat e llamarines 200 cm x 100 cm spesor δ 3 mm

7. HEKUR NDERTIMI

Parametri teknik :Hekur $\varnothing=8$ mm i viaskuar

Sigma = 2400 Kg/ cm2

8. HEKUR NDERTIMI

Parametri teknik :Hekur $\varnothing=10$ mm i viaskuar

Sigma = 2400 Kg/ cm2

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Argumentim Teknik: Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenin 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ato janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor, duke përshkruar karakteristikat minimale teknike dhe funksionale që duhet të plotësojnë materialet e kërkuara, me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të tyre.

Materialet objekt prokurimi, konkretisht çimentoja, rëra, granili, hekuri i ndërtimit, zgarat e hekurit, profilet metalike dhe llamarinat, do të përdoren për ndërtimin e varreve, realizimin e konstruksioneve prej betoni, punimeve metalike dhe ndërhyrjeve të tjera ndërtimore në Sektorin Funeral. Për këtë arsye, është e domosdoshme që materialet të plotësojnë parametrat teknikë të kërkuar, në mënyrë që të sigurohet rezistenca mekanike, qëndrueshmëria strukturore dhe jetëgjatësia e veprave që do të realizohen.

Specifikimet teknike janë hartuar duke përcaktuar vetëm kërkesat minimale të nevojshme për realizimin e qëllimit të kontratës dhe nuk përmbajnë kërkesa të panevojshme apo kufizuese që mund të cenojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Përmasat, diametrat, trashësitë, karakteristikat mekanike dhe parametrat e tjerë teknikë janë përcaktuar në funksion të përdorimit të tyre në punimet ndërtimore të sektorit funeral dhe përfaqësojnë minimumin e kërkuar për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e punimeve.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike janë objektivisht të lidhura me objektin e kontratës, janë proporcionale me nevojat që synohen të plotësohen dhe respektojnë parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, duke u mundësuar të gjithë operatorëve ekonomikë që ofrojnë materiale me karakteristika të njëjta ose ekuivalente të marrin pjesë në procedurën e prokurimit në kushte të barabarta.